

## Shtojca 10

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

**1\* Stativë Serumi** - Stativët të jenë prej profilesh rrethore, metal (celik) inoksidabël, dy mbajtëse serumi, pozicionim të mbajtëses së serumit në lartësi të ndryshme nëpërmjet një fiksueseje në vertikalisht, por jo më pak se 215cm, dhe kontakti me tokën të jetë me rrota.

**2 Karrocë Invalidi** – Karrocë invalidi manual, skelet celik i kromuar, me mbajtëse krahësh dhe këmbësh të fiksuara, me shtresë lëkure, me dy rrota të vogla me diametër jo më pak se 20cm dhe me 2 rrota të pasme me diametër jo më pak se 58cm. Të mbajë peshë jo më pak se 100kg.

**3\* Barrelë për transferim pacienti** - Për transferimin e pacientit gjatë pozicionit foëler (nga barrela në tavolinën e operacionit apo anasjelltas), grafisë ose krevat; Të funksionojë me rrëshqitje pa e ngritur pacientin, për të shmangur dëmtimet e pacientit gjatë këtij kalimi, për të shmangur tronditjet apo traumat e pacientit, si carje plagësh ku aktualisht bëhet me carcafë. Të jetë i përbërë nga tre shtresa, një shtresë e hollë sfungjer polietileni, shtresa totale të jetë e butë dhe funksionimi të jetë pa rrula metalik; Të ketë përmasa jo më të vogla se 172x52cm; Të jetë i palosshëm dhe i lehtë në përdorim; Të mundësojë transferimin e pacientit edhe në pozicion ulur; Të jetë elastik dhe i fortë me peshë jo më shumë se 3.2 kg; Të mbajë pacientë me peshë jo më pak se 225kg.

**4 Krevat Barrelë** – Krevat Barrelë e thjeshtë emergjence, me strukturë celiku, pjesa e shtratit të mund të ndahet nga skeleti dhe të përdoret si barrelë, përmasat jo më pak se : me gjatësi 190cm me dyshek, gjerësi 57 cm, dhe lartësi 65 cm. të jetë lehtësisht i komandueshëm;

**5\* Krevat Barrelë me tre funksione** - Krevat me strukturë celik - inoks me gjatësi jo më pak se 195cm dhe me tre pozicione: lartësi e rregullueshme deri në 750mm nga toka; pozicioni shpine 0-70gradë; pozicioni këmbë dero në 30gradë, me katër rrota universale me diametër jo më pak se 12cm nga të cilat dy duhet të jenë me frena, mbrojtëset anësore mund të ulen dhe ngrihen, dyshek sfungjeri i cilësisë së lartë me mbrojtëse PU dhe rezistent ndaj ujit, të jetë i pajisur me një raft mbajtës, një mbajtëse për cilindrin e oksigjenit, stativë serumi dhe dyshek. Pajisje fiksuese; mundësi mbajtëse serumi dhe jastëk, si dhe mbajtëse Oksigjeni.

**6 Barrelë/karrike elektrike pacienti për ngjitjen e shkallëve** – Karrige elektrike alumini me mundësi palosje për ngjitjen e shkallëve me lehtësi për spital, kompakte dhe e lehtë në transportim. Ngjit dhe zbret shkallët me lehtësi dhe siguri, nuk rrëshket ose bie kur ndalon në shkallë, si dhe shtypet celësi i emergjencës ‘ndalo’. Me 4 rrota gome rezistente që përdoret edhe si karrige invalidi; me “buton ndalimi emergjent”, të jetë shumë e sigurtë për pacientin. Me motor silencioz, rezistent ndaj ujit dhe qark të sigurt brenda tubit, bateri lituimi e pozicionuar larg trupit të pacientit. E pajisur me siguresa për lidhjen e pacientit. Me aksesorët: rrip beli, set montimi, konforter sfungjeri.

*Shënim: Për zërat me shenjën \* duhet paraqitur mostër.*

## Shtojca 11

### SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1*	Stativë serumi	copë	200
2	Karrocë invalidi	copë	10
3*	Barrelë për transferim pacienti	copë	2
4	Krevat/barrelë	copë	30
5*	Krevat/barrelë me tre funksione	copë	2
6	Barrelë/karrige elektrike pacienti për ngjitjen e shkallëve	copë	1

Afatet e lëvrimit: Lëvrimi i mallit do bëhet pjesor ose total sipas kërkesave të QSUT por gjithsesi jo më vonë se datë 31.12.2016.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë nga data e nënshkrimit të kontratës deri më datë 31.12.2016.